



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

VENDIM

NR. 152, DATË 11.10.2019

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “Mbi procedurat dhe kriteret për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit”**

Në zbatim të nenit 19, pika 16 dhe neneve 75 dhe 77 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores “Mbi procedurat dhe kriteret për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për veprime të mëtejshme sipas ligjit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar: Gentian

SALA

Zëvendëskryetar: Sami

NEZAJ

Anëtarë: Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA

150



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**RREGULLORE
MBI PROCEDURAT DHE KRITERET PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE
MEDIATIKE AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIVE SIPAS KËRKESËS SË
PËRDORUESIT**

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe kriterëve të përcaktuara në nenet 75, 76 dhe 77 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit.

**Neni 2
Përkufizime**

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “AMA” është Autoriteti i Mediave Audiovizive.
2. “Autorizim” është leja që i jepet subjektit nga AMA, për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit.
3. “Aplikues” është personi fizik/juridik me seli në territorin e Republikës të Shqipërisë, i cili kërkon të pajiset me autorizim;
4. “Aplikim” kërkesa për autorizim pasqyruar në formularin e aplikimit, së bashku me dokumentacioni përkatës, që paraqitet në AMA nga aplikuesi;
5. “Kritere” janë kushtet dhe kriteret për dhënien e autorizimit për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit;
6. “Ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA)” është personi fizik ose juridik, që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj.
7. “Përgjegjësi editoriale” do të thotë ushtrimi i kontrollit efektiv për përzgjedhjen e programeve dhe për organizimin e tyre në një katalog, në rastin e shërbimeve të programit audioviziv, sipas kërkesës.

8. "Shërbimet audiovizive, sipas kërkesës" janë shërbimet jolineare mediatike audiovizive të ofruara nga ofruesi i shërbimit mediatik në momentin e zgjedhur nga përdoruesi, në bazë të kërkesës së tij, mbështetur në një katalog programi të ofruar për këtë qëllim nga ofruesi i shërbimit mediatik.
9. "Transmetim jolinear" është ofrimi i shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv për marrje, sipas kërkesës individuale dhe në momentin e zgjedhur nga përdoruesit.
10. "Transmetimi televiziv" është transmetimi linear i një shërbimi audioviziv, i siguruar nga OSHMA për shikimin e njëkohshëm të programeve, mbi bazën e një skeme programesh.
11. "Vepra europiane" janë:
 - a) veprat që e kanë origjinën në shtetet anëtare të Bashkimit Europian;
 - b) veprat që e kanë origjinën në shtete, të cilat janë palë në Konventën Europiane për Televizionin Ndërkufitar të Këshillit të Europës, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 8525, datë 9.9.1999 "Për ratifikimin e konventës europiane për televizionin ndërkufitar" dhe që plotësojnë kushtet e përcaktuara në shkronjën "c" të kësaj pike;
 - c) veprat e përmendura në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike janë vepra të prodhuara kryesisht nga autorë dhe me punonjës që e kanë rezidencën e tyre në një nga shtetet anëtare të përmendura në shkronjën "a" dhe "b" të kësaj pike dhe që plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:
 - i) janë prodhuar nga një ose më shumë prodhues të themeluar në një ose më shumë nga këto shtete;
 - ii) prodhimi i veprave mbikëqyret dhe kontrollohet efektivisht nga një ose më shumë prodhues të themeluar në një ose më shumë nga këto shtete;
 - iii) kontributi i bashkëprodhuesve të këtyre shteteve, në koston totale të prodhimit të përbashkët, është dominues dhe bashkëprodhimi kontrollohet nga një ose më shumë prodhues të themeluar në këto shtete;
 - ç) veprat e bashkëprodhuara në kuadër të marrëveshjeve që lidhen me sektorin e transmetimeve audio dhe/ose audiovizive, të përfunduara ndërmjet Bashkimit Europian dhe shteteve të treta dhe që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këto marrëveshje;
 - d) veprat, të cilat nuk janë evropiane, në kuptimin e shkronjave "a" dhe "b" të kësaj pike, por që janë prodhuar, në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe për prodhim të përbashkët, të përfunduara ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit Europian dhe shteteve të treta, konsiderohen vepra europiane, kur bashkëprodhuesit nga Bashkimi Europian ofrojnë pjesën më të madhe të kostove të prodhimit dhe kur prodhimi nuk kontrollohet nga një ose më shumë prodhues të vendosur jashtë territorit të shteteve anëtare të Bashkimit Europian.

Termat e tjerë në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 3

Kriteret e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit

1. OSHMA-ja e pajisur me licencë/autorizim për transmetime televiziv ka të drejtë të pajiset me autorizim për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit.
2. Ofrimi i shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit bëhet me autorizim të AMA-s, pa garë, mbi bazën e aplikimit pranë AMA.
3. Aplikuesi për ofrimin e shërbimeve mediatike dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit nuk është i detyruar të depozitojë Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit në AKEP.
4. Aplikuesi për marrje autorizimi për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit, duhet të kryejë pagesën për përpunimin e dokumentacionit, përpara depozitimit të aplikimit, ose brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit për kryerjen e pagesës nga AMA, në të kundërt aplikimi i tij arkivohet pa u shqyrtuar.

Seksioni II
DOKUMENTACIONI PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT

Neni 4
Formulari i Aplikimit

1. Aplikuesi për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit duhet të depozitojë pranë AMA aplikimin në përputhje me kërkesat e kësaj rregullore. Aplikimi përbëhet nga formulari i aplikimit dhe dokumentacioni shoqërues.
2. AMA miraton përmbajtjen dhe formën e formularit të aplikimit sipas modelit bashkëlidhur rregullores në Aneksin I.
3. Formulari i aplikimit është pjesë përbërëse e dokumentacionit të aplikimit.
4. Aplikuesi duhet të plotësojë në mënyrë të saktë dhe të plotë të dhënat e formularit të aplikimit, në përputhje me dokumentacionin e aplikimit.
5. Formulari i aplikimit mund të shkarkohet nga aplikuesi në faqen zyrtare në internet të AMA-s ose mund të tërhiqet pa pagesë pranë zyrave të AMA-s.

Neni 5
Dorëzimi i aplikimit

1. Aplikimi për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit mund të dërgohet me postë ose të depozitohet dorazi në protokollin e AMA-s, si shërbim shtesë nga OSHMA që kryen transmetime televizive.
2. Aplikimi duhet të paraqitet i mbyllur në zarf, i cili duhet të jetë i vulosur, firmosur dhe me mbishkrimin ku të saktësohet aplikimi përkatës.
3. Aplikimi duhet të përmbajë dokumentacion origjinal, ose fotokopje të noterizuar.
4. Çdo dokument, që merret në institucionet shtetërore, duhet të jetë marrë jo më vonë se 30 ditë nga momenti i dorëzimit të aplikimit në AMA.

Neni 6

Dokumentacioni për marrje autorizimi për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit

1. Aplikimi për marrjen e autorizimit për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit duhet të përmbajë dokumentacionin, si më poshtë vijon:
 - Aplikuesi duhet të plotësojë në mënyrë të saktë dhe të plotë të dhënat e formularit të aplikimit, sipas modelit bashkëlidhur rregullores, (Aneksi I).
- a. **Kërkesat juridike**
 - Emërtimi, vendndodhja e subjektit që depoziton aplikimin.
 - Ekstrakti i thjeshtë dhe historik për të dhënat e subjektit lëshuar nga Qendra Kombëtare të Biznesit (QKB) për subjektin që bën kërkesën, bashkë me emrin dhe firmën e personit, që ka të drejtë t'a përfaqësojë atë, kur nuk përfaqësohet direkt nga përfaqësuesi ligjor, lëshuar jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e aplikimit.
 - Emërtimi tregtar i ofruesit të shërbimit dhe rrjetit ku do të mbështetet.
 - b. **Kërkesat teknike**
 - Përshkrim të shkurtër të shërbimit që do të ofrohet.
 - Informacion se cili rrjet komunikimi elektronik do të përdoret për shpërndarjen e shërbimit përkatës.
 - Faqen web, portalin apo aplikacionin përmes të cilit bëhet i mundur shërbimi.
 - c. **Kërkesat programore**
 - Të dhëna mbi formatin e katalogut të përmbajtjeve, të cilat i ofron si shërbime mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit, pranë të cilit do të ofrohet shërbimi shtesë.
 - d. **Kërkesat lidhur me mbikëqyrjen**
 - Dokumentacioni (kontratë, marrëveshje, etj.) që të vërtetojë të drejtën e transmetimit të programeve, përshi edhe veprave kinematografike, të nënshkruar me mbajtësit e të drejtave të tyre.
 - e. **Kërkesat mbi burimet njerëzore**
 - Dokumentacioni i cili të paraqesë mënyrën e organizimit dhe drejtimit (organigrama) të aplikuesit.
 - Lista me emrat e anëtarëve të bordit etik, me një përbërje prej jo më pak se tre persona, ekspertë të fushës së medias si dhe Curriculum Vitae (CV) respektive.
 - f. **Kërkesat financiare**

- Raport vlerësimi i ekspertit kontabël të miratuar/autorizuar, mbi burimet e financimit për vitin e parë të ushtrimit të veprimtarisë së vet. Masa e burimeve të financimit nuk duhet të jetë më pak se shpenzimet e parashikuara për ushtrimin e veprimtarisë, objekt i aplikimit.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve fiskale për 6 mujorin e fundit para paraqitjes që aplikimit.

Neni 7
Shqyrtimi i Aplikimit

1. AMA vendos për aplikimin e depozituar brenda 30 ditëve nga depozitimi i aplikimit, të plotësuar me të gjitha kërkesat ligjore dhe ato të kësaj rregulloreje, për autorizim. Nëse AMA nuk shprehet zyrtarisht brenda këtij afati, autorizimi konsiderohet i miratuar.
2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për aplikimet të cilat rezultojnë me të meta dhe jo në përputhje me kërkesat ligjore dhe ato të kësaj rregulloreje.
3. Vendimi i AMA-s për pranimin ose rrëzimin e aplikimit merret sipas ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe dispozitave të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.
4. Kundër vendimit të AMA-s, për rrëzimin e aplikimit për marrje autorizimi për ofrimin e shërbimit sipas kërkesës së përdoruesit mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

Neni 8
Detyrimet e subjektit të autorizuar për ofrimin e shërbimeve mediatike sipas kërkesës së përdoruesit

1. Subjektet e autorizuar për ofrimin e shërbimeve mediatike sipas kërkesës së përdoruesit nuk lejohet të përfshijnë programe që nxisin urrejtjen mbi baza racore, etnike, gjinore, kombëtare ose fetare.
2. Veprat kinematografike në këto shërbime duhet të transmetohen në bazë të kushteve të miratuara me mbajtësit e të drejtave përkatëse për këto vepra.
3. Dispozitat e ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi për komunikimet tregtare audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare dhe reklamat zbatohen edhe për shërbimet mediatike audio dhe/ose audiovizive, në bazë të kërkesës së përdoruesit.
4. Shërbimet mediatike audio dhe/ose audiovizive, në bazë të kërkesës së përdoruesit, që mund të dëmtojnë rëndë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve, transmetohen në formë të koduar, të tillë që të sigurojnë mosmarrjen e tyre nga të miturit në kushte të zakonshme.
5. Subjekti i autorizuar për ofrimin e shërbimeve mediatike sipas kërkesës së përdoruesit njofton AMA-n për çdo ndryshim të të dhënave të paraqitura në aplikim.

155

Neni 9 Detyrimet financiare

1. Paguesa vjetore për autorizim, pagesa për përpunimin e dokumentacionit dhe pagesa për marrjen e autorizimit, do të kryhet bazuar në vendimin e AMA-s, nr. 220, datë 01.12.2017 “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”.
2. Paguesa vjetore për autorizim kryhet brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik. Në rastin kur pagesa kryhet pas kalimit të këtij afati, aplikohet një kamatë vonesë në masën 0.1% të vlerës së pagesës vjetore për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 30% e vlerës së detyrimit financiar.

Neni 10 Detyrimi për promovimin e prodhimit të veprave europiane

1. Shërbimet mediatike audio dhe/ose audiovizive, sipas kërkesës së përdoruesit, të ofruara nga operatorët e shërbimit të medias brenda juridiksionit të tyre promovojnë, kur është e mundur dhe me mjete të përshtatshme, prodhimin e veprave europiane dhe aksesin ndaj këtyre veprave.
2. Katalogu i programeve të një ofruesi të një shërbimi mediatik audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit duhet të përmbajë të paktën 20%, vepra europiane.
3. Promovimi i veprave europiane mund të bëhet përmes kontributit financiar që shërbime të tilla mediatike akordojnë për prodhimin dhe blerjen e të drejtave të punëve europiane, ose në përqindjet dhe/ose dominimin e veprave europiane në katalogun e programeve të ofruara nga shërbimet mediatike audio dhe/ose audiovizive, sipas kërkesës së përdoruesit.

Neni 11 Kohëzgjatja e autorizimit

1. Autorizimi për ofrimin e shërbimeve mediatike sipas kërkesës së përdoruesit lëshohet për një afat 5 vjeçar, duke filluar nga data e dhënies së autorizimit, me të drejtë rinovimi.
2. Vlefshmëria e autorizimit përfundon kur:
 - a) ofruesi i shërbimit njofton me shkrim AMA-n për mbylljen e aktivitetit;
 - b) nuk e ushtron aktivitetin për më shumë se një vit;
 - c) nuk përmbush kërkesat teknike dhe kërkesat programore të transmetimit të programeve;
 - d) ka një vendim të formës së prerë nga gjykata që ndalon ushtrimin e aktivitetit nga i autorizuari.

Neni 12 Regjistri i Autorizimeve

1. AMA administron regjistrin e ofruesve të shërbimit mediatik sipas kërkesës së përdoruesit së bashku me historikun e veprimeve.
2. Regjistri i autorizimeve është publik dhe i aksesueshëm në faqen zyrtare të AMA-s.
3. Regjistri i autorizimeve që publikohet do të përmbajë këto të dhëna:
 - i. Emrin e subjektit person fizik/juridik.
 - ii. emri tregtar si OSHMA.
 - iii. numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT).
 - iv. përfaqësuesi ligjor i regjistruar në QKB.
 - v. të dhënat (telefon, fax, email) të kontaktit me AMA.
 - vi. një përshkrim të shkurtër të aktivitetit që do të kryejë në fushën e shërbimit audio dhe/ose shërbim të programit audioviziv.
 - vii. llojin e rrjetit ku mbështetet shërbimi që ofron.
 - viii. numrin dhe datën e lëshimit të autorizimit nga AMA.
 - ix. datën e përfundimit të vlefshmërisë së autorizimit.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga AMA në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 14
Publikimi

Kjo rregullore publikohet në faqen zyrtare në internet të AMA-s.

157



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Formular Aplikimi për Autorizim

1. TË DHËNAT E SUBJEKTIT APLIKUES

Emri i subjektit (subjekt juridik/person fizik):.....

Emri tregëtar:.....

Adresa e Subjektit:.....

.....

Telefon:.....Fax:.....

E-mail:.....Faqja WEB:.....

Të dhënat e personit të autorizuar:

Emri:.....Mbiemri:.....

Adresa:.....

Telefon:.....Fax:.....

[Type here]

2. LLOJI I AUTORIZIMIT TË KËRKUAR*.

Shërbimi mediatik audio dhe/ose audiovizive sipas Kërkesës së Përdoruesit:

- Autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv.
- Autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve.
- Autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audio.
- Autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audio të të tretëve.

ZONA PER TE CILEN KERKOHET AUTORIZIMI:**

- Qarku.....
- Bashkia.....
- Njësia Administrative.....

*Ky formular vlen vetëm për 1 lloj autorizimi. Subjekti duhet të zgjedhë vetëm 1 kuti.

** Aplikanti duhet të përmbushë kriteret sipas Rregullores së miratuar me Vendimin Nr.____ datë: _____.2019.

[Type here]

3. PËRMBAJTJA E DOKUMENTACIONIT TË APLIKIMIT		
<u>Dokumentat e kërkuara</u>		Plotëso nr e faqeve.
Juridike / Mbikqyrje	Emërtimi, vendndodhja e subjektit që depoziton aplikimin.	
	Ekstrakti i thjeshtë dhe historik për të dhënat e subjektit lëshuar nga Qendra Kombëtare të Biznesit (QKB) për subjektin që bën kërkesën, bashkë me emrin dhe firmën e personit, që ka të drejtë t'a përfaqësojë atë, kur nuk përfaqësohet direkt nga përfaqësuesi ligjor, lëshuar jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e aplikimit.	
	Emërtimi tregtar i ofruesit të shërbimit dhe rrjetit ku do të mbështetet.	
	Dokumentacioni (kontratë, marrëveshje, etj.) që të vërtetojë të drejtën e transmetimit të programeve, përfshirë edhe veprat kinematografike, të nënshkruar me mbajtësit e të drejtave të tyre.	
Ekonomike	Raport vlerësimi i ekspertit kontabël të miratuar/autorizuar, mbi burimet e financimit për vitin e parë të ushtrimit të veprimtarisë së vet. Masa e burimeve të financimit nuk duhet të jetë më pak se shpenzimet e parashikuara për ushtrimin e veprimtarisë, objekt i aplikimit.	
	Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve fiskale për 6 mujorin e fundit para paraqitjes që aplikimit.	
Programme	Të dhëna mbi formatin e katalogut të përmbajtjeve, të cilat i ofron si shërbime mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit, pranë të cilit do të ofrohet shërbimi shtesë	
Teknike	Përshkrim të shkurtër të shërbimit që do të ofrohet.	
	Informacionin se cili rrjet komunikimi elektronik do të përdoret për shpërndarjen e shërbimit përkatës.	
	Faqen web, portalin apo aplikacionin përmes të cilit bëhet i mundur shërbimi.	

[Type here]

Organizative	Dokumentacion për mënyrën e organizimit dhe drejtimit të aplikuesit (organigrama).	
	Lista me emrat e anëtarëve të bordit etik, me një përbërje prej jo me pak se tre persona, ekspertë të fushës së medias si dhe Curriculum Vitae (CV) respektive.	

4. DETAJE LIGJORE													
NIPT:													
<table border="1" style="width: 100%; height: 20px;"> <tr> <td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td> </tr> </table>													
Person fizik/Ortakë/Aksionerë:													
NR.	Emër Mbiemër	Adresa	Përqindja e aksioneve										

[Type here]

[Type here]

6. DEKLARATA

Unë /e nënshkruari/a
deklaroj se informacioni që kam dhënë është i saktë dhe i plotësuar sipas kriterëve të përcaktuara nga AMA dhe në përputhje me Rregulloren Nr. ___ datë __. __. 2019.

Përfaqësuesi Ligjor:

.....
Emër Mbiemër Nënshkrimi	Pozicioni

Personi i Autorizuar:

.....
Emër Mbiemër Nënshkrimi	Pozicioni

Data: . . .

[Type here]